



Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

BULETINI ELEKTRONIK
E-MAPAS
NR.50

**TË ARDHURAT DHE KOMPENSIMET
E FONDEVE PENSIONALE
MË 31.12.2023**

Mjetet e fondeve pensionale i përbëjnë kontributet e paguara dhe kontributet nga kontributet e investuara të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar, minus kompensimet e paguara.

Në rregullore janë përcaktuar qëllimet dhe parimet e investimit, si dhe llojet e instrumenteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale. Shoqëria pensionale është e detyruar të investojë mjetet e fondit pensional në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe me strategjinë dhe taktikat e veta të investimit. Realizimi i rezultateve pozitive (të ardhurat) nga investimi i mjeteve në sigurimet pensionale të financuara nga kapitali janë nxitësi kryesor i rritjes së fondeve pensionale.

Kontributi i paguar në fondin pensional konvertohet në njësitë e kontabilitetit sipas vlerës së njësisë së kontabilitetit në ditën kur paguhet në varësi nga fondi ku është anëtar i siguruari.

Si tregues bazë i performancave të portofolit të fondit pensional është lëvizja e vlerës së njësisë kontabël , përkatësisht norma e të ardhurave të realizuar nga investimi i mjeteve të fondeve të pensionit. Përcaktohet dhe llogaritet në vlerë nominale dhe reale për 7 vitet e mëparshme. Të ardhurat e fondit të pensionit në shumë nominale përfaqësojnë ndryshimin në përqindje të vlerës së njësisë kontabël për një periudhë 7-vjeçare të konvertuar në një normë ekuivalente vjetore të të ardhurave në një shumë nominale. Të ardhurat në vlerë reale për një periudhë 7-vjeçare, të konvertuara në normë ekuivalente kthimi vjetor në shumën reale, përfaqëson normën e të ardhurave në shumën nominale të korigjuar për ndryshimin e nivelit të shpenzimeve të jetesës në periudhën e llogaritjes.

**PENSIONI ËSHTË NJË FLETË
BOSHE. ËSHTË NJË
SHANS PËR TA RIDIZAJNUAR
JETËN TUAJ NË DIÇKA
TË RE DHE TË NDRYSHME.**

PATRICK FOLEY

**PËR SHUMICËN, PENSIONI
ËSHTË KOHA PËR RITJE
PERSONALE, E CILI BËHET
RRUGË PËR MË SHUMË LIRI.**

ROBERT DELAMONTAGUE



Në vijim janë të ardhurat e realizuara nga fondet e obliguara dhe vullnetare pensionale më 31.12.2023:

Të ardhurat nga fondet e obliguara pensionale⁽¹⁾

31.12.2023

FOP	Periudha					
	12 muajt e fundit		vjetore për 7 vitet e fundit		vjetore nga fillimi i punës	
	31.12.2022 - 31.12.2023 ⁴⁾		31.12.2016 - 31.12.2023 ²⁾ / 30.06.2019 - 31.12.2023 ³⁾		Fillimi - 31.12.2023 ⁴⁾	
	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale
SAVA ₃	8.11%	4.33%	5.12%	0.51%	5.33%	2.24%
KPB ₃	7.27%	3.53%	5.23%	0.63%	5.54%	2.44%
TRIGLLAV ₃	6.95%	3.22%	3.40%	-2.76%	3.26%	-2.61%
Të ardhura mesatare⁵⁾	6.57%	2.85%	4.63%	0.05%	5.23%	2.14%

¹⁾Të ardhurat e llogarisë individuale janë të ndryshueshme dhe varen nga të ardhurat e fondit të pensionit të obligueshëm dhe tarifat e ngarkuara nga shoqëria.

²⁾të ardhurat llogariten në bazë vjetore për 84 muajt e mëparshëm. Si përjashtim, nëse fondi ekziston për më pak se 84 muaj, por më shumë se 12 muaj, të ardhurat llogariten në fund të tremujorit, për periudhën nga 1 qershori ose dhjetori pas themelimit të fondit deri në fund të tremujorit kur është bërë llogaritja.

³⁾Të ardhurat e TRIGLLAV₃ llogariten për periudhën 30.06.2019 - 30.09.2023 sepse fondi ekziston më pak se 84 muaj, por më i gjatë se 12 muaj.

⁴⁾Shtesë të ardhurat llogariten për 12 muajt e mëparshëm dhe në bazë vjetore nga fillimi i punës së fondit të pensionit.

⁵⁾Të ardhurat mesatare llogariten nëpërmjet vlerës mesatare të njëjësive kontabël.

Vlera mesatare e njëjësive kontabël llogaritet si mesatare e ponderuar e njëjësive kontabël të fondeve të pensionit të obligueshëm në raport me mjetet neto të fondeve të pensionit të obligueshëm që funksionojnë në datën përkatëse.

(1) Një njësi kontabël përfaqëson një pjesë proporcionale të aktiveve të përgjithshme neto të fondit pensional



FVP	Periudha					
	12 muajt e fundit		vjetore për 7 vitet e fundit		vjetore nga fillimi i punës	
	31.12.2022 - 31.12.2023 ⁵⁾		31.12.2016 - 31.12.2023 ²⁾ / 30.06.2021 - 31.12.2023 ³⁾ / 31.12.2022 - 31.12.2023 ⁴⁾		Fillimi ⁶⁾ - 31.12.2023 ⁵⁾	
	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale	Në shumë nominale	Në shumë reale
SAVAd	8.46%	4.67%	5.32%	0.71%	5.68%	2.62%
KBPd	6.46%	2.74%	4.81%	0.22%	5.59%	2.47%
TRIGLLAVd	6.37%	2.66%	3.01%	-6.16%	2.90%	-5.99%
VFPd	8.20%	4.42%	8.20%	4.42%	5.87%	2.44%
Të ardhura mesatare⁷⁾	6.79%	3.06%	4.89%	0.30%	5.47%	2.42%

- 1) Të ardhurat në llogarinë individuale është i ndryshueshëm dhe varet nga të ardhurat e fondit pensional vullnetar dhe tarifat e paguara nga shoqëria.
- 2) Të ardhurat llogariten në bazë vjetore për 84 muajt e mëparshëm. Si përjashtim, nëse fondi ekziston për më pak se 84 muaj, por më shumë se 12 muaj, të ardhurat llogariten në fund të tremujorit, për periudhën nga 1 qershori ose dhjetori pas themelimit të fondit deri në fund të tremujorit kur është bërë llogaritja.
- 3) Të ardhurat e TRIGLLAVd llogariten për periudhën 30.06.2019 - 30.09.2023 sepse fondi ekziston më pak se 84 muaj, por më i gjatë se 12 muaj.
- 4) Të ardhurat e VFBd llogariten për periudhën 31.12.2022 - 31.12.2023 sepse fondi ekziston më pak se 84 muaj, por më i gjatë se 12 muaj.
- 5) Shtesë të ardhurat llogariten për 12 muajt e mëparshëm dhe në bazë vjetore nga fillimi i punës së fondit të pensionit.
- 6) Në llogaritjen për fillimin e punës të SAVAd merret 31.7.2009, të KBPd merret 31.12.2009 dhe të VFPd merret 31.10.2022.
- 7) Të ardhurat mesatare llogariten nëpërmjet vlerës mesatare të njësive kontabël.

Vlera mesatare e njësive kontabël llogaritet si mesatare e ponderuar e njësive kontabël të fondeve të pensionit vullnetar në raport me mjetet neto të fondeve pensionale vullnetare që funksionojnë në datën përkatëse.

Në **linkun** e mëposhtëm mund të shihni të ardhurat e realizuara të fondeve pensionale

Kompensime

Për ushtrimin e funksioneve të veta për menaxhimin me mjetet e fondeve pensionale, vlerësim i mjeteve, anëtarësim, mbajtje e llogarive të anëtarëve dhe informim të anëtarëve, si dhe për pagimin e kompensimeve për MAPAS, FSPIMV dhe për ruajtësin e pronës dhe mbulimin e shpenzimeve personale, shoqëritë, në përputhje me normativën ligjore, nga anëtarët e fondit pensional mund të paguajnë vetëm kompensimet e mëposhtme:



1. Kompensime nga të ardhurat 1,9% për vitin 2023 dhe 1,8% për vitin 2024 si përqindje e çdo kontributi të paguar të anëtarëve të fondit pensioni të obligueshëm përpara se këto kontribute monetare të konvertohen në njësi kontabël të fondit të pensionit. Sava Pension Plus dhe CB Fondi i Parë i Pensionit Vullnetar paguajnë 2.5% për fondin e pensionit vullnetar, kurse Fondi Pensional Vullnetar Trigllav dhe Fondi i Hapur i Pensionit VFP paguajnë 2.9% për anëtarët e fondit pensional vullnetar. Kompania pensionale paguan gjithashtu tarifa më të vogla për anëtarët e skemave të pensioneve profesionale në fond pensional vullnetar, të ndryshëm nga ato të listuara.
2. Tarifë mujore prej 0,03% të vlerës së totalit të mjeteve neto të fondit pensional të obligueshëm dhe 0,075% për fond pensional vullnetar për të mbuluar shpenzimet e shoqërisë, për menaxhimin e fondit pensional ose tarifë për menaxhimin e aseteve.
3. Kompensim për transferim (kompensim i njëfishtë) në rast transferimi të mjeteve në një fond tjetër pensioni, me kusht që anëtari transferues të ishte anëtar i fondit ekzistues:
 - më pak se 720 ditë në shtyllën e dytë, kompensim prej 15 eurosh në vlerë denari dhe
 - më pak se 360 ditë në shtyllën e tretë para se të kalojë në fondin e ardhshëm, kompensim prej 10 eurosh në vlerë denari.

Nga mjetet e fondit pensional paguhen edhe provizione të transaksioneve në lidhje me transaksionet për fitim apo transferim të mjeteve në fondin pensional.

Të gjitha shpenzimet e tjera në lidhje me menaxhimin e mjeteve të pensionit që nuk janë mbuluar me provizione, kompensime apo të dala të përcaktuara me ligj, janë peshë e shoqërisë e cila menaxhon me atë fond pensional.

Në **linkun** e mëposhtëm mund t'i shikoni kompensimet të cilat i paguajnë shoqëritë.



NËNSHKRUHET MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME AGJENCINË KROATE PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMEVE FINANCIARE (HANFA)

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara drejt qëllimit strategjik – Përmirësimin të kapaciteteve në drejtim të forcimit të rolit të saj mbikëqyrës dhe rregullator në sigurimin pensional të financuar nga kapitali, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS, më 10 korrik 2024, ishte mysafir i Agjencisë Kroate për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare (Hanfa) në Republikën e Kroacisë.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



MAPAS KA REALIZUAR NJË HULUMTIM PËR VETËDIJESIMIN E ANËTARËVE NË FONDET E DETYRUESHME PENSIONALE

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS ka realizuar një hulumtim për vetëdijësimin e anëtarëve në fondet e detyrueshme pensionale, gjatë muajve maj dhe qershor 2024, si pjesë e aktiviteteve të planifikuara drejt qëllimit strategjik – Promovimi dhe mirëmbajtja e një sigurim pensional të qëndrueshëm dhe transparent me financim kapital që ka mbështetjen e anëtarësimin dhe publikut. Hulumtimi për nevojat e MAPAS-it është realizuar nga Kompania për Marketing dhe Konsulencë MARKET VISION SHPKNJ Shkup.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.

AKSIONI HUMANITAR I MAPAS-IT PËR NDIKIM POZITIV SOCIAL

Si institucion përgjegjës shoqëror Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS, vazhdojmë traditën e aksioneve për mbledhjen e fondeve, me të cilat duam të frymëzojmë dhe të japim shembull pozitiv për institucionet dhe kompanitë e tjera që të angazhohen në aksione humanitare dhe të krijojnë një aksion pozitiv me ndikim social.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL
MBAJTI TAKIM PUNE ME PËRFAQËSUESIT E BANKËS KOMBËTARE
TË SLOVAKISË DHE NËNSHKRUAN MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

Në suazat e aktiviteteve të parapara si qëllim strategjik për përmirësim të kapacitetit në drejtim të përforcimit të rolit të vet rregullator dhe të mbikëqyrjes në financimin kapital të sigurimit pensional, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit kapital të Sigurimit Pensional – MAPAS, më 11 dhe 12 shtator 2024 i mirëpriti përfaqësuesit e Bankës Kombëtare të Sllovakisë.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në
contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: (02) 3224 229
www.mapas.mk



www.mapas.mk



[mapas.mk](https://www.facebook.com/mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.instagram.com/mapas.mk)



[mapasmk](https://www.linkedin.com/company/mapasmk)